



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 134
Prishtinë, më 29 tetor 2010

PROCES\VERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 TETOR 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 96 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kryesuesi në vijim tha se për fjalë është paraqitur, në emër të GP PDK-së, deputeti Hydajet Hyseni.

Hydajet Hyseni në emër të GP PDK-së, dhe të deputetëve nënshkrues për inicimin e Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë, i cili është miratuar kohë më parë, në parim, në këtë Kuvend, propozoi që i njëjti Projektligj të hyjë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të sotme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Buxhet

dhe Financa, Gani Koci, si dhe deputetët: Armend Zemaj, Gani Geci, Ardian Gjini, Zafir Berisha, Sabri Hamiti, Ramë Buja, Adem Salihaj, Arsim Bajrami, Fatmir Rexhepi, Adem Grabovci dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e z. Hydajet Hyseni që Projektligji për të drejtat e ish të burgosurve politikë të hyjë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të sotme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----30,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin e z. Hydajet Hyseni që Projektligji për të drejtat e ish të burgosurve politikë të hyjë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të sotme.

Kryesuesi konstatoi se kjo pikë radhitet si pikë nr. 2 e rendit të ditës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Bahri Hyseni.

Raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Fatmir Rexhepi.

Raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve e arsyetoi anëtarja e këtij komisioni, Sanije Aliaj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë deputetët: Emrush Xhemajli, Ismet Beqiri, Flora Brovina, Driton Tali, Riza Smaka, Rexhep Hoti, Sanije Aliaj, Naim Rrustemi, Fatmir Rexhepi, Ismajl Kurteshi, Bujar Dugolli, Gani Buçinca dhe Donika Kadaç – Bujupi, që janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe amendamenti nr. 3 të plotësuar.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë.

Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Bahri Hyseni.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Gani Koci.

Opinionin e tij për këtë Projektligj e dha edhe deputeti Riza Smaka.

Kryesuesi më pas hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 i plotësuar, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi njëzëri Ligjin për të drejtat e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

Kryesuesi konstatoi se mbledhja plenare e radhës do të mbahet më 2 nëntor 2010, në ora 12:00

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 15:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale